



Komisioni
Evropian

PËR NJË RAJON TË BEGATË DHE TË INTEGRUAR TË ADRIATIKUT DHE JONIT

*Politikën
Rajonale
dhe Urbane*

QERSHOR 2014

Europe Direct është një shërbim që ju ndihmon t'i jepni përgjigje pyetjeve që keni rreth Bashkimit Evropian.

**Numri i telefonit pa pagesë (*):
00 800 6 7 8 9 10 11**

(*) Informacioni që jepet është falas, siç është edhe shumica e telefonatave (edhe pse disa operatorë, kabina telefonike apo hotele mund t'ju mbajnë një tarifë).

Për më tepër informacion mbi Bashkimin Evropian vizitoni faqen e internetit (<http://europa.eu>).

Luksemburg: Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian, 2014

ISBN 978-92-79-43156-2
doi:10.2776/30529

© European Union, 2014

Riprodhimi i botimeve autorizohet me kusht që të citohet burimi.

Fotografitë në kopertinë: © Shutterstock.com – Shën-Stefan, Mal i Zi, Ballkan, deti Adriatik

Fotografitë në faqen 3: © European Union/Gino de Lorenzo

Fotografitë në faqet e brendshme: © Shutterstock.com

Printed in Belgium

Tabela e përmbajtjes

- 1** Pse nevojitet një strategji e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit?
- 2** Për çfarë flet kjo strategji? Cilët janë qëllimet e saj?
 - 2.1** Rritja blu
 - 2.2** Lidhja midis vendeve të rajonit
 - 2.3** Cilësia e mjedisit
 - 2.4** Turizmi i qëndrueshëm
- 3** Çfarë vjen më pas? Zbatimi në terren

Informacione të mëtejshme

1

Pse nevojitet një strategji e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit?

Ne, anëtarët e Këshillit të Adriatikut dhe Jonit (AIC) jemi të bindur se Strategjia e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit (EUSAIR) do t'i japë një shtysë të re bashkëpunimit dhe investimeve në dobi të gjithë palëve të përfshira dhe si dhe paqes e siguri-së në të gjithë zonën. •

*Takimi i 17-të i Këshillit Adriatiko-Jonian
Deklarata e Brukselit
13 maj 2014, Bruksel*

Për një rajon të begatë dhe të integruar të Adriatikut dhe Jonit

Një rajon ku jetojnë më shumë se 70 milion njerëz dhe pikë kyçe për vazhdimësinë gjeografike të Evropës, Rajoni i Adriatikut dhe i Jonit është një zonë funksionale e karakterizuar kryesisht nga pellgu i Adriatikut dhe i Jonit.

Strategjia e BE-së bazohet mbi Nismën Adriatiko-Joniane⁽⁴⁾, e cila u zyrtarizua në vitin 2000 dhe përfshiu tetë vende: katër shtete anëtare të BE-së (Kroacia, Greqia, Italia dhe Sllovenia) dhe katër shtete jo anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia).

Me qëllim trajtimin e një sërë sfidash urgjente socio-ekonomike dhe mjedisore me të cilat përballlet Rajoni, Këshilli Evropian i mbajtur më 13-14 dhjetor 2012 i kërkoi Komisionit Evropian të paraqiste një strategji makrorajonale për

Rajonin e Adriatikut dhe Jonit deri në fund të vitit 2014.

Duke u bazuar në strategji të mëparshme për Rajonin e Detit Baltik (EUSBSR) dhe Rajonin e Danubit (EUSDR), Komisioni tani po miraton një Plan Komunikimi dhe Veprimi për Strategjinë e BE-së, i cili përqendrohet në Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR). Kjo strategji e re përfshin gjithashtu edhe Strategjinë Detare për Detin Adriatik dhe Jon, miratuar nga Komisioni më 30 nëntor 2012.

EUSAIR do të promovojë rritjen ekonomike dhe begatinë në rajon, duke përmirësuar fuqinë e tij tërheqëse, konkurrueshmërinë dhe kapacitetin lidhës. Ajo gjithashtu ka si qëllim të mbrojë mjedisin detar, bregdetar si dhe mjedisin dhe ekosistemet tokësore.

Përveç këtyre, Strategjia pritet që të integrojë më mirë në BE si vendet candidate ashtu edhe vendet që aspirojnë të bëhen candidate, nëpër të gjithë rajonin.

Sfidat dhe mundësitë me të cilat përballlet Rajoni

Në sot vëmë re ndryshime shumë të dukshme socio-ekonomike ndërmjet vendeve të Rajonit. Ndërkohë që disa vende gëzojnë një nivel të ulët papunësie, ka vende të tjera ku niveli i saj është më i madh se 30 %. Edhe prodhimi i brendshëm bruto (PBB) për frymë ndryshon shumë ndërmjet vendeve të ndryshme.

Vendet ndryshojnë ndjeshëm nga njëra-tjetra edhe në drejtim të infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe detare. Ka gjithashtu nevojë urgjente për më shumë investime në rrjetet e energjisë elektrike, për të pasur furnizim të sigurt dhe efikas nëpër të gjithë rajonin.

Ekosistemet janë nën një trysni të madhe për shkak të përdorimit gjithnjë në rritje nga njerëzit të hapësirave detare dhe bregdetare. Mbi-peshkimi, mbetjet e pa trajtuara, ndotja nga nafta dhe gazi dhe gjuetia e paligjshme e zogjeve shtegtarë janë të gjitha çështje shumë të rëndësishme.

Përveç veprimtarive të larta sizmike, Rajoni gjithashtu rrezikohet nga ndryshimet klimatike – përmbytjet, thatësira, erozioni i tokës dhe zjarret në pyje janë të gjitha situata reale që po shtohen.

Për sa i përket potencialit ekonomik, sektori i turizmit nuk menaxhohet apo shfrytëzohet në mënyrë optimale dhe ai mund të përfitojë nga një koordinim më i mirë.

Përveç kësaj, administratat dhe institucionet e Rajonit mund të përfitojnë, ndër të tjera, nga mundësitë për modernizim dhe lidhje më të mira me qëllim që të luftojnë migrimin e paligjshëm dhe krimin ndërkufitar.

Objektivi, në kombinim dhe me masa të tjera, është krijimi i mundësive të mëtejshme për një rritje të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjit-



Konferenca e Grupeve të Interesit për Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit, Athinë, 6-7 shkurt 2014

hëpërfshirëse në të gjithë Rajonin e Adriatikut dhe Jonit. Për shembull, ekziston një mundësi e madhe që Ekonomia Blu të lulëzojë dhe të ndryshojë faqen e Rajonit.

Për sa i përket lëvizshmërisë, baseni i detit ofron një rrugë ujore natyrore që depërton thellë në BE. Ndaj, ekziston një potencial i madh për të përmirësuar kapacitetin lidhës tokë-det dhe transportin intermodal.

Gjithashtu ekziston edhe mundësia për investime në përmirësimin e sektorit energjetik, si për shembull rrjetet inteligjente, rritja e efikasitetit të energjisë si dhe përdorimit të burimeve të rinovueshme.

Bukuria e madhe natyrore e zonës dhe trashëgimia e pasur kulturore, historike dhe arkeologjike gjithashtu kanë një potencial të dukshëm për një

turizëm të qëndrueshëm, të përgjegjshëm dhe të diversifikuar.

Një plan veprimi konkret

Në një raport të vitit 2013⁽²⁾, Komisioni theksoi se strategjitë e reja makrorajonale duhet të përqendrohen te një numër i kufizuar objektivash të mirë përcaktuara dhe se këto objektiva duhet të zbatohen nëpërmjet një plani veprimi të qartë. Me pak fjalë, qëllimi është që të kalohet nga “fjalët te veprat” duke identifikuar përparësitë konkrete për makrorajonin, duke shfrytëzuar sa më mirë institucionet, legjislacionin dhe fondet ekzistuese për një përmirësim të shpejtë.

EUSAIR është bazuar mbi katër shtylla tematike:

- Rritja blu.
- Lidhja midis vendeve të rajonit.
- Cilësia e mjedisit.
- Turizmi i qëndrueshëm.

Për më tepër “Fuqizimi i kërkimit dhe zhvillimit, novacionit dhe SME-ve” dhe “Ngritja e kapaciteteve, duke përfshirë komunikimin” janë dy aspekte ndërsektoriale që lidhin secilën shtyllë.

1 Nisma ndërqeveritare adriatiko-joniane ka nisur në vitin 2000 me qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal, për të promovuar stabilitetin politik dhe ekonomik duke krijuar kështu një bazë të qëndrueshme për procesin e integritimit Evropian.

2 Raport në lidhje me vlerën e shtuar të strategjive makrorajonale, COM (2013) 468 përfunduar më 27.6.2013.

2

Për çfarë flet kjo strategji? Cilët janë qëllimet e saj?

2.1

Rritja blu

Rritja Blu është një strategji afatgjatë për të zhbllkuar potencialin e zonave detare dhe bregdetare të Evropës. Ajo mbulon tema të tilla si energjia blu, akuakultura, turizmi detar, bregdetar dhe turizmi i lundrimit, burimet minerale detare dhe bioteknologja blu.

Shtylla e Rritjes Blu do të promovojë zhvillimin novator detar në rajonin e Adriatikut dhe Jonit. Kjo do të arrihet duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe duke hapur vende të reja pune si edhe mundësi të reja biznesi.

Shtylla e Rritjes Blu do të përqendrohet në tre tema:

- Teknologjitë blu.
- Peshkimi dhe akuakultura.
- Shërbimet dhe rregullimi ligjor i sektorit detar.

Teknologjitë blu

Rajoni i Adriatikut dhe Jonit aktualisht nuk po shfrytëzon përparësitë që i jepen nga teknologjitë blu, gjë që mund të arrihet me një bashkëpunim më të mirë.

Me qëllimin për t'i dhënë hov teknologjive blu në rajon, do të zhvillohen kërkim-zhvillimi makrorajonal (R&D) dhe platformat e novacionit në fusha të tilla si lëvizshmëria ekologjike në

det, burimet në det të thellë, biosiguria dhe bioteknologjitë.

Do të ngrihen gjithashtu grupe makrorajonale në sektorë premtues si ndërtimi ekologjik i anijeve dhe materiale të reja për të nxitur ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME-të). Ideja e “qarkullimit të trurit” sipas të cilës kërkuesit lëvizin në institucione, universitete dhe kompani të ndryshme do të bëhet realitet. Përfundimisht, bizneset e reja mund ta kenë më të lehtë të përfitojnë akses në financim dhe promovim.

SHEMBULL I NJË PROJEKTI *Robotika detare në platforma kërkimi*
Për të fuqizuar mjetet detare pa personel për operacione në ujore dhe në shtratin e detit bazuar në bashkëpunimin ekzistues ndërmjet grupeve të interesit në rajon.
Ky projekt mund të kontribuojë gjithashtu për të zhvilluar platforma për rrjetet makrorajonale të spirales katërpalëshe që lidhin grupet e interesit në fushën e kërkimit, biznesit, sektorit publik dhe shoqërisë civile.

Peshkimi dhe akuakultura

Peshkimi dhe akuakultura janë të dy sektorë të rëndësishëm për rritjen blu në Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit.

Për sa i përket peshkimit, qëllimi është që të promovohen praktika të qëndrueshme dhe të përgjegjshme peshkimi që do të sigurojnë një fluks të qëndrueshëm të ardhurash për zonat bregdetare. Kjo do të arrihet përmes:

- përmirësimit të mbledhjes së të dhënave për peshkimin, monitorimit dhe kontrollit;
- zbatimit të planeve për menaxhimin e peshkimit në nivel baseni të detit;
- harmonizimit të standardeve në të gjithë rajonin;
- përmirësimit të aftësive dhe kapacitetit për të vepruar në pajtim me rregullat dhe standardet e BE-së;
- rritjes së vlerës së shtuar të zinxhirit të vlerës së ushqimit detar lokal;
- zhvillimit të inteligjencës së tregut dhe tregtimit dhe përpunimit më transparent.

Aktualisht, ekzistojnë një sërë barrierash që parandalojnë zhvillimin e potencialit të plotë të akuakulturës në pellgun e Adriatikut dhe Jonit. Këto përfshijnë:

- aksesin e kufizuar në hapësirë dhe licencim;
- fragmentimin e industrisë;
- aksesin e kufizuar në kapitalin fillestar ose kreditë për novacion;
- procedurat administrative dhe rregulloret e tepërta që hanë kohë.

Strategjia propozon promovimin e akuakulturës së qëndrueshme nëpërmjet përfshirjes së grupeve të interesit, krijimit të procedurave të thjeshtuara si edhe diversifikimit të produktit.

Platforma për monitorimin e rezervave të peshkut

Kryerja e vlerësimeve të rregullta për rezervën e peshkut në detet Adriatik dhe Jon dhe vlerësimi i elementeve kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të peshkimit.

Shërbimet dhe rregullimi ligjor i sektorit detar

Vendet e Rajonit të Adriatikut dhe Jonit kanë struktura të ndryshme administrative dhe politike, qeveri dhe sisteme qeverisjeje të ndryshme. Nevojiten trajnime dhe një koordinim më i mirë i aktiviteteve të planifikimit për shërbime më të mira dhe rregullim më të mirë ligjor të sektorit detar.


Kjo do të arrihet nëpërmjet shkëmbimit të të dhënave, planifikimit të përbashkët dhe menaxhimit të koordinuar të burimeve ekzistuese.

Planifikimi hapësinor detar i koordinuar

Sigurimi i një kuadri ligjor koherent për veprimtaritë ekonomike në det duke u bazuar në punën e projektit ADRIPLAN dhe duke i vendosur të gjitha ujërat nën juridiksionin kombëtar nëpërmjet procesit të Planifikimit Hapësinor Detar.

Siç theksohet edhe në strategjinë tonë Rritja Blu, detet dhe oqeanet kanë potencialin për të gjeneruar një rritje të madhe ekonomike dhe për të hapur vende pune që janë shumë të nevojshme. Vendet adriatiko-joniane tashmë kanë treguar se kanë vullnetin për t'i trajtuar bashkërisht sfidat e Rajonit.⁹

Maria Damanaki,
Komisionere Evropiane
për Çështjet Detare dhe të Peshkimit



2.2

Lidhja midis vendeve të rajonit

Fragmentimi i rajonit të Adriatikut dhe Jonit ka çuar në pabarazi në infrastrukturë – veçanërisht ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe atyre jo anëtare. Nevojiten lidhje më të mira në transport dhe energji, të cilat janë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit.

Shtylla "Lidhja midis vendeve të rajonit" do të përmirësojë kapacitetin lidhës në transport dhe energji duke:

- forcuar sigurinë detare dhe duke zhvilluar një sistem portesh;
- krijuar rrjete të besueshme transporti dhe lidhje intermodale me zonat në brendësi;
- ngritur një treg të brendshëm energjie të lidhur mirë dhe që funksionon mirë.

Për t'i arritur këto objektiva kjo shtyllë do të përqendrohet në tre tema:

- Transporti detar.
- Lidhjet intermodale me zonat në brendësi.
- Rrjetet e energjisë.

Transporti detar

Portet e Adriatikut verior janë porta hyrëse natyrore për në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe deri në vitin 2030 mund të zënë mbi 10% të tregut të trafikut të kontejnerëve të BE-së, nëse sigurohet një rrugë hyrëse hekurudhore e mirë për në zonat në brendësi. Ndaj nxitja e transportit detar është thelbësore, po aq sa edhe ngritja e porteve intermodale efikase për të integruar transportin detar me hekurudhat dhe rrugët.

Përmirësimi i kapacitetit lidhës brenda rajonit dhe ndërmjet rajonit dhe pjesës tjetër të BE-së ka nevojë për një qasje të koordinuar.

Veprimet në zbatim të kësaj teme përfshijnë:

- Grupimi i veprimtarive dhe shërbimeve portuale në të gjithë rajonin për të tërhequr një trafik më të madh.
- Shkëmbimi i shpeshtë i informacionit ndërmjet vendeve bregdetare nëpërmjet një Sistemi të përbashkët monitorimi dhe informacioni për trafikun e mjeteve lundruese në rajonin adriatiko-jonian për të përmirësuar sigurinë e trafikut detar në rajon.
- Zhvillimi i porteve dhe terminaleve portuale për të nxitur transportin detar, kapacitetin e transportit bregdetar dhe kapacitetin lidhës ndërkufitar me tragete.

SHEMBULLI NË PROJEKTIN *Përmirësimi dhe harmonizimi i monitorimit dhe menaxhimit të trafikut*
Përmirësimi i Sistemit aktual të Raportimit për Trafikun në Adriatik (ADRIREP) për të reduktuar administrimin dhe dublikimin e panevojshëm të të dhënave të mbledhura nga infrastrukturat e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Trafikut të Mjeteve të Lundrimit.


Lidhjet intermodale me zonat në brendësi

Lidhjet intermodale me zonat në brendësi duhet të përmirësohen për të përballuar transportin e shtuar detar të mallrave. Së bashku me rrugët ujore të brendshme, rrugët dhe hekurudhat sigurojnë lidhje ndërkombëtare të rëndësishme brenda rajonit.

Portet e deteve Adriatik dhe Jon, së bashku me linjat hekurudhore dhe aeroportet, janë pika hyrëse të shpejta për në rajon. Një qasje e përshtatshme ndaj transportit duhet të marrë në konsideratë të gjithë këta faktorë, së bashku me aspektet mjedisore, rritjen ekonomike dhe zhvillimin social.

Veprimet në zbatim të kësaj teme përfshijnë:

- Zhvillimin e rrjeteve gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë hekurudhën, rrugët ujore të brendshme, pikat lidhëse dhe qendrat e aktivitetit, si dhe përgatitjen për integrimin e tyre në Rrjetin e transportit trans-evropian (TEN-T).
- Përmirësimin e aksesibilitetit në zonat bregdetare dhe ishuj duke optimizuar përdorimin e rrugëve të transportit të mallrave dhe të pasagjerëve me përfshirjen e grupeve private dhe publike të interesit.
- Zhvillimin e autostradave detare nëpërmjet infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të përmirësuar që lidh portin me zonat në brendësi, infrastrukturës së përmirësuar dhe zgjidhjeve të ITS-së.
- Ofrimin e lidhjeve më të mira të transportit ajror brenda Rajonit dhe përmirësimin e lidhjeve ajrore rajonale me vendmbërritjet e huaja.



Përmirësimi i aksesibilitetit në zonat bregdetare dhe ishuj
Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet pronarëve të anijeve, autoriteteve portuale, autoriteteve publike, operatorëve turistikë dhe shoqatave turistike për të përmirësuar lidhjet detare ndërmjet vendeve fqinje, ishujve dhe kontinenteve.

Rrjetet e energjisë

Tre objektivat e politikës së BE-së për energjinë – konkurrueshmëria, furnizimi i sigurtë dhe qëndrueshmëria – mund të arrihen vetëm nëpërmjet një tregu të brendshëm energjie të ndërlidhur dhe funksional. Për t'i arritur këto objektiva janë parashikuar veprimet e mëposhtme:


- Përmirësimi i lidhjeve ndërkufitare të energjisë elektrike.

- Ndërtimi i unazës së gazit në rajon për të rritur sigurinë e furnizimit dhe për të promovuar integrimin e tregut.
- Prezantimi i një tregu të energjisë elektrike që funksionon mirë duke ngritur Zyrën e Koordinimit të Ankandëve që do të ofrojë kapacitete të shtuara transmetimi në treg.
- Masa rregullatore për të hequr barrierat në investimet ndër-kufitare.

Heqja e barrierave për investimet ndër-kufitare
Koordinimi dhe bashkërendimi i lejeve dhe rregulloreve.

“Kjo është strategjia e tretë makro-rajonale e Evropës dhe kemi mësuar rëndësinë e përkushtimit politik dhe të përqendrimit të përpjekjeve të vendeve pjesëmarrëse në qasjen makrorajonale. Ky do të jetë çelësi për suksesin e kësaj strategjie.”

Johannes Hahn,
 Komisioner Evropian
 për Politikën Rajonale





2.3

Cilësia e mjedisit

Cilësia e mjedisit është thelbësore për të siguruar mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve të rajonit. Kjo shtyllë do të trajtojë cilësinë e mjedisit nëpërmjet bashkëpunimit në nivel rajonal. Konkretisht ajo do të:

- sigurojë një status të mirë mjedisor dhe ekologjik të mjedisit detar dhe bregdetar deri në vitin 2020;
- ndihmojë në ndalimin e humbjes së biodiversitetit dhe përqësimit të shërbimeve të ekosistemit në BE, deri në vitin 2020;
- përmirësojë menaxhimin e mbetjeve duke ulur fluksin e mbetjeve dhe ushqyesve në det dhe lumenj.

Për t'i arritur këto objektiva, përqendrimi do të jetë në tri tema:


- Mjedisi detar.
- Ndotja e detit.
- Habitatet tokësore dhe biodiversiteti ndërkuftar.

Mjedisi detar

Reziqet për biodiversitetin bregdetar dhe detar

Në detet Adriatik dhe Jon jetojnë pothuajse gjysma e të gjitha specieve detare të regjistruara që gjenden në Detin Mesdhe. Megjithatë, ato i nënshtrohen një veprimtarie peshkimi të lartë, zhvillimit të akuakulturës dhe atij bregdetar, të cilët rrezikojnë këtë habitat natyror. Ekziston një mungesë e përgjithshme informacioni për peshkimin në shkallë të ulët, pajisjet e paligjshme të peshkimit nuk janë të pazakonta dhe monitorimi dhe zbatimi janë të pamjaftueshme.

Nevojitet një koordinim i veprimtarive i bazuar në ekosistem për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve.



Kjo do të arrihet përmes:

- marrjes së informacionit të mëtejshëm mbi planifikimin hapësinor detar, menaxhimin e integruar të zonave bregdetare dhe zbatimin e Direktivës kuadër për strategjinë detare;
- rritjes së rrjetit ndërkufitar, të ujërave të hapura për zonat e mbrojtura detare;
- shkëmbimit të praktikave më të mira midis autoriteteve menaxhuese të zonave të mbrojtura detare;
- zbatimin të planifikimit hapësinor detar dhe menaxhimit të integruar të zonave bregdetare.

SHËMBULL I NJË PROJEKTI *Shkëmbimi i praktikave më të mira midis autoriteteve menaxhuese të zonave të mbrojtura detare*
Bazuar në punën e Rrjetit të Zonave të Mbrojtura të Adriatikut (AdriaPAN), krijimi rrjetit të autoriteteve menaxhuese të Zonave të Mbrojtura Detare në detet Adriatik dhe Jon për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të punuar për masat që nevojiten për të përmirësuar situatën ekologjike të deteve.

Ndotja e ujit

Transporti detar intensiv në mënyrë të pashmangshme çon në derdhje të naftës dhe ndotje akustike. Ndotja nga lumenjtë shkaktohet nga trajtimi i pamjaftueshëm i ujërave të zeza si edhe nga përdorimi i tepruar i nitrateve në tokat bujqësore. Përveç se shkakton kosto të mëdha për transportin, hedhja e mbeturinave në det ndikon në sigurinë dhe shëndetin e njerëzve si edhe në jetën e egër detare.

Veprimet e parashikuara në zbatim të kësaj teme përfshijnë:

- investimet e koordinuara në impiantet për trajtimin e ujërave dhe mbetjeve të ngurta;

- përpjekjet e përbashkëta për të trajtuar të gjithë ciklin e jetës së mbeturinave të hedhura në det;
- planifikimin e përbashkët dhe ngritjen e kapaciteteve për të parandaluar dhe për të marrë masat ndaj derdhjeve të naftës dhe ngjarjeve të tjera;
- ndërgjegjësimin e fermerëve për ndikimet negative të përdorimit të tepërt të nitratit.

SHËMBULL I NJË PROJEKTI *Zbatimi i një qasjeje për të gjithë ciklin jetësor të mbeturinave të hedhura në det*
Bazuar në projektin CleanSeaNet, që ofron një analizë të mbeturinave të hedhura në det, do të zhvillohen masat për një menaxhim efektiv në kosto dhe zgjidhje nëpërmjet politikave për të trajtuar këtë çështje.

Habitatet tokësore dhe biodiversiteti ndërkufitar

Pritet që ndryshimet klimatike të kenë ndikim mbi habitatet natyrore dhe biodiversitetin në rajonin e deteve Adriatik dhe Jon, më shumë se kudo në BE. Rreziqet e ndryshimeve klimatike për biodiversitetin mund të ulen duke forcuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke rritur kështu aftësinë e tyre për t'u përshtatur me këto ndikime.

Bashkëpunimi gjithashtu do të përqendrohet në mbrojtjen dhe ruajtjen e ekosistemeve tokësore, në veçanti të habitateve ndërkufitare dhe elementeve të peizazhit që kanë rëndësi të veçantë për speciet e zogjve shtetgarë dhe gjiarëve mishngrënës.

Veprimet specifike përfshijnë:

- zhvillimin e planeve të përbashkëta për menaxhimin e habitateve dhe ekosistemeve ndërkufitare;
- planet e përbashkëta për menaxhimin e niveleve të popullatës së gjiarëve

mishngrënës dhe veprimtaritë e ndërgegjesimit;

- harmonizimin dhe zbatimin e ligjeve kombëtare sipas legjislacionit të BE-së;
- mbrojtjen dhe rikuperimin e zonave të ligatinave bregdetare dhe fushave karstike;
- veprimtaritë ndërgjegjësuere për praktika bujqësore që nuk dëmtojnë mjedisin.

SHËMBULL I NJË PROJEKTI *Zhvillimi i planeve të përbashkëta për menaxhimin e habitateve tokësore dhe ekorajoneve ndërkufitare*
Duke u bazuar në projektin BE-NATURA, do të zhvillohen mjete për një menaxhim dhe zbatim më të mirë në territoret e NATURA 2000 (lumenj, liqene dhe zona bregdetare).

6 Pas vitesh të tëra me vështirësi politike dhe ekonomike, Rajoni i Adriatikut dhe i Jonit ka përpara një të ardhme më të ndritur. Duke ofruar një kuadër të përgjithshëm për koordinimin e politikave dhe bashkëpunimin territorial, Strategjia do ta kthejë rajonin në një vend më të mirë për të jetuar, punuar dhe për t'iu gëzuar jetës. Ai mund të shërbejë si një shembull për zhvillimin, hapjen e vendeve të punës dhe krijimin e ideve dhe si një portë hyrëse për në pjesë të tjera të botës. Përpjekjet e përbashkëta mund ta përgatisin mirë rajonin për sfidat dhe mundësitë e shekullit të 21.⁹

Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin për Rajonet në lidhje me Strategjinë e Bashkimit Evropian për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit

2.4 Turizmi i qëndrueshëm

Zhvillimi i potencialit të rajonit për sa i përket turizmit të qëndrueshëm mund të përshpejtohet duke ofruar produkte dhe shërbime turistike novatore dhe cilësore. Rëndësi ka edhe një sjellje e përgjegjshme ndaj turizmit, që përfshin të gjithë aktorët e këtij sektori.

Objektivat kryesorë të kësaj shtylle janë:

- diversifikimi i shërbimeve dhe produkteve të turizmit të makrorajonit dhe trajtimi i çështjes së turizmit sezonal;
- përmirësimi i cilësisë dhe qasjet novatore.

Për t'i arritur këto objektiva, shtylla do të përqendrohet në dy tema:

- Një ofertë turistike e diversifikuar.
- Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm i turizmit.


Oferta turistike e diversifikuar

Edhe pse turizmi tashmë është një nga veprimtaritë ekonomike me rritjen më të shpejtë në rajon, trashëgimia natyrore, kulturore, historike dhe arkeologjike e rajonit ende nuk është shfrytëzuar plotësisht.

Bashkëpunimi në nivel makrorajonal do të nxisë përpjekjet për ta diversifikuar turizmin në një mënyrë të qëndrueshme, për të ulur varësinë e sektorit nga modeli sezonal dhe për të kufizuar ndikimin e tij në mjedis.

Për t'i arritur këto qëllime janë planifikuar veprimet e mëposhtme:

- Ndërtimi i "markës" adriatiko-joniane me vlerat që janë në harmoni me produktet dhe shërbimet në rajon.
- Diversifikimi dhe zgjerimi i sektorit të lundrimit dhe atij nautik në ekonomitë e zonave të brendshme bregdetare.
- Ngritja e një platforme për kërkim dhe zhvillim në universitete, qendrat e kërkimit dhe komunitetin e biznesit për të krijuar produkte dhe shërbime turistike të reja.
- Promovimi i rrugëve të reja turistike për shëtitje, çiklizëm, lundrim, etj.
- Afrimi me trashëgiminë kulturore adriatiko-joniane duke punuar së bashku me sektorin kulturor.
- Përmirësimi i aksesit në produktet dhe shërbimet turistike për grupe të moshuarish, njerëz me aftësi të kufizuara, grupe me të ardhura të pakta, etj.



Ndërtimi i markës së rajonit adriatiko-jonian

Promovimi i "markës" adriatiko-joniane për produkte dhe shërbime turistike të diversifikuara që kanë si grupe të synuara klientët e udhëtimeve globale.

Menaxhimi i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm i turizmit

Turizmi i qëndrueshëm nuk është aq i zhvilluar sa duhet në rajon. Veprimtaritë turistike jo gjithmonë menaxhohen siç duhet dhe kjo mund të ketë një ndikim negativ në mjedisin bregdetar, detar dhe tokësor. Duhet të zhvillohet një qasje tregtare por edhe e qëndrueshme.

Veprimet e parashikuara në këtë temë përfshijnë:

- ngritjen e një rrjeti të bizneseve dhe grupimeve të turizmit të qëndrueshëm për të nxitur novacionin dhe për të krijuar sinergji me sektorët plotësues;
- sigurimin e fondeve për biznese novatore në turizmin novator dhe të qëndrueshëm, SME-të dhe bizneset e themeluara mbi bazën e kërkimeve universitare që do të sjellin produkte dhe shërbime të reja në sektor;
- promovimin e rajonit në tregjet botërore me anë të marketingut dhe reklamimit;
- shtrirjen e sezonit turistik përgjatë gjithë vitit duke e pozicionuar rajonin adriatiko-jonian si një destinacion të shkëlqyer edhe jashtë sezonit për breza më të moshuar, konferenca, etj.

- kryerjen e trajnimeve për aftësitë sipërmarrëse në turizëm;
- krijimin e një Karte Adriatiko-Joniane për turizmin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm, që ka si grup të synuar ata që punojnë në këtë sektor.

Asistenca për akses në financim për biznese të reja në turizëm
Zgjerimi i "Financimit për turizmin e qëndrueshëm adriatiko-jonian" për të zhvilluar instrumente financimi novatore, për të mbështetur qasjen në kapital fillestar dhe kapital me risk.

Aspektet ndërsektoriale

"Fuqizimi i kërkimit dhe zhvillimit, novacionit dhe SME-ve" dhe "Ndërtimi i kapaciteteve, duke përfshirë komunikimin" janë dy aspekte ndërsektoriale me rëndësi për shtyllat e Rritjes blu, kapacitetit lidhës të rajonit, cilësisë së mjedisit dhe turizmit të qëndrueshëm. Aspektet kyçe janë të pranishme në çdo shtyllë.

Përveç këtyre aspekteve ndërsektoriale, zbutja dhe përshtatja ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike si edhe menaxhimi i reziqeve të fatkeqësive natyrore janë pranuar gjithashtu si parime horizontale për të katër shtyllat.

Rritja blu

- Veprimet në zbatim të "qeverisjes dhe shërbimeve të sektorit detar" kërkojnë rritjen e kapaciteteve administrative dhe institucionale në mbështetje të sektorit publik.

- Veprimet në zbatim të "peshkimit dhe akuakulturës" përfshijnë fuqizimin e aftësive të menaxhimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit.
- Veprimet në zbatim të "teknologjisë blu" dhe "peshkimit dhe akuakulturës" mund të përfitojnë nga një fokusim më i madh në kërkim dhe novacion.

Lidhja midis vendeve të rajonit

- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të organeve kombëtare dhe rajonale përgjegjëse për transportin do të përshpejtojë modernizimin.
- Komunikimi dhe ndërgjegjësimi janë të rëndësishme për pjesëmarrjen aktive në procesin e vendimmarrjes.
- Investimet efikase në transport dhe rrjetet e energjisë kërkojnë qasje novatore të lidhura me kërkime të përditësuara.

Cilësia e mjedisit

- Ngritja e kapaciteteve dhe komunikimi janë të nevojshme për masa efektive mjedisore.
- Nevojiten kërkime dhe novacione më të mira për të dhëna të besueshme për situata referuese dhe për pasojë për të monitoruar ecurinë.
- Gjithashtu ekziston një nevojë e qartë për shkëmbimin e njohurive ekzistuese dhe asetëve shkencore.

Turizmi i qëndrueshëm.

- Zhvillimi i SME-ve dhe ndërtimi i kapaciteteve mund të sjellë përfitime si për aktorët privatë ashtu edhe për organet publike, të cilët duhet të bashkëpunojnë mes tyre.
- Komunikimi i mirë dhe ndërgjegjësimi janë thelbësore për promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm dhe për të ndihmuar në trajtimin e sezonalitetit.

A topographic map of Italy showing regional boundaries with dashed lines. Major cities are marked with black squares, and some are labeled. A red dot is placed in the Adriatic-Ionian region, specifically in the area of Basilicata. The sea is shown in light blue, and the land is in shades of brown and tan.

Rajoni adriatiko-jonian



3

Çfarë vjen më pas? Zbatimi në terren

Harmonizimi i fondeve ekzistuese nga BE-ja dhe fondeve kombëtare

EUSAIR do të mobilizojë dhe harmonizojë instrumentet financiare ekzistuese të BE-së dhe ato kombëtare për secilën nga temat e identifikuara për katër shtyllat.

Në veçanti, Fondi Evropian Struktural dhe i Investimeve (ESIF) për periudhën 2014-2020, si edhe Instrumenti për Asistencës të Para-Anëtarësimit (IPA) për vendet jo anëtare të BE-së, ofrojnë burime financiare të konsiderueshme.

Qasja makrorajonale tashmë është përfshirë në Rregulloren e re për periudhën e programimit 2014-2020. Marrëveshjet e partneritetit dhe programet operacionale për vendet anëtare të BE-së (Kroacia, Greqia, Italia dhe Sllovenia) po marrin në konsideratë edhe EUSAIR që do të miratohet së shpejti. Gjithashtu, dokumente strategjike kombëtare për shtetet jo anëtare të BE-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia) i referohen qartazi Strategjisë.

Mund të sigurohen edhe burime të tjera financimi, duke rritur mundësitë e financimit në mbështetje të veprimtarive bashkëpunuese në të gjithë makrorajonin.

Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) ofron financime dhe asistencë teknike për investimet strategjike, veçanërisht në zhvillimin e infrastrukturës, sektorit energjtitik dhe atij privat. Banka Evropiane për Investim (BEI) dhe institucione të tjera financiare ndërkombëtare gjithashtu mund të mobilizojnë fonde dhe ekspertizë në mbështetje të projekteve të përshtatshme.

Janë të disponueshme edhe fonde përkatëse sipas shtyllave specifike:

- Fondi Evropian për Sektorin Detar dhe Peshkimin dhe Horizon 2020, që e ka Rritjen Blu një nga fushat kryesore të tij për RTD-në, mund të japë mbështetje kyçe për zbatimin e masave dhe projekteve të shtyllës 1.
- Për shtyllën 2, Faciliteti për Infrastrukturën Lidhëse të Evropës (CEF) 2014-2020 mbështet zhvillimin e rrjeteve ndër evropiane me performancë të lartë, të qëndrueshme dhe të ndërlidhura në mënyrë efikase në fushën e transportit, energjisë dhe shërbimeve dixhitale.
- Për sa i përket shtyllës 3, fondet e programit LIFE janë të hapura edhe për vende jo anëtare të BE-së.
- Shtylla 4 mund të përfitojë nga programi COSME për SME-të.

Qeverisje më e mirë

Përvoja me strategjitë ekzistuese makrorajonale tregon se mekanizmat e qeverisjes së mirë dhe të qëndrueshme janë thelbësore për një zbatim efikas.

Në fakt, Raporti i Komisionit Evropian për qeverisjen në maj 2014 evidenton dy nevoja kryesore:

- lidership politik më të fortë dhe vendim-marrje efikase;
- qartësi më e madhe dhe organizim më i mirë i veprimeve ditë pas dite.

Raporti thekson se qeverisja duhet të ketë një dimension sa politik edhe funksional, ku ministrinë e linjës dhe organet zbatuese të vendosin objektiva strategjike dhe të vendosin së bashku se si t'i arrijnë ato dhe më pas të organizohen për t'u siguruar për ndjekjen me rigorozitet të punës. Kjo do të japë rezultate më të qarta dhe një ndikim më të madh.

Informacione të mëtejshme

Strategjitë makrorajonale të Be-së:

http://ec.europa.eu/regional_policy/cooperate/macro_region_strategy/index_en.cfm

Strategjia e BE-së për rajonin e Adriatikut dhe të Jonit:

http://ec.europa.eu/regional_policy/cooperate/adriatic_ionian/index_en.cfm

Konferenca e Grupeve të Interesit për Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe të Jonit (Athinë 6-7 shkurt 2014):

http://ec.europa.eu/regional_policy/conferences/adriatic_ionian/index_en.cfm

Faqja e internetit INTERACT:

http://www.interact-eu.net/macro_regional_strategies/macro_regional_strategies/283/14370

Pellgu i Adriatikut dhe i Jonit:

http://ec.europa.eu/maritimeaffairs/policy/sea_basins/adriatic_ionian/index_en.htm

Studim për bashkëpunimin në pellgun e Adriatikut dhe të Jonit:

Përmbledhje ekzekutive:

https://webgate.ec.europa.eu/maritimeforum/sites/maritimeforum/files/Exec%20sum%20Adr-Ion_31-3-2013.pdf

Raporti i plotë:

https://webgate.ec.europa.eu/maritimeforum/sites/maritimeforum/files/Report%202_21_03_2014.pdf

Broshurë për Rritjen Blu (të dhënat sipas shtetit dhe basenit detar):

http://ec.europa.eu/maritimeaffairs/policy/blue_growth/infographics

Për të kontaktuar me stafin e Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit Evropian për Politikën Rajonale dhe Urbane, dërgoni një email në: REGIO-EU-ADRIATIC-IONIAN-STRATEGY@ec.europa.eu

KU T'Ë GJENI BOTIMET E BE-së

Botimet falas:

- një kopje:
nëpërmjet EU Bookshop (<http://bookshop.europa.eu>);
- më shumë se një kopje ose posterë/harta:
nga përfaqësitë e Bashkimit Evropian (http://ec.europa.eu/represent_en.htm);
nga delegacionet në vendet jo anëtare të BE-së (http://eeas.europa.eu/delegations/index_en.htm);
duke kontaktuar me shërbimin Europe Direct (http://europa.eu/eurodirect/index_en.htm)
ose duke telefonuar në numrin 00 800 6 7 8 9 10 11 (telefonatë falas nga çdo shtet i BE-së) (*).

(*) Informacioni jepet falas, ashtu siç janë edhe shumica e telefonatave (edhe pse disa operatorë, kabina telefonike ose hotele mund t'ju mbajnë një tarifë).

Botimet me pagesë:

- nëpërmjet EU Bookshop (<http://bookshop.europa.eu>).

Abonimet me pagesë:

- nëpërmjet njerit nga agjentëve të shitjes në Zyrën e Botimeve të Bashkimit Evropian (http://publications.europa.eu/others/agents/index_en.htm).

